



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA

Pranuar · Prilbena Me 30-06-2026			
Nr. Llogarit Org. Broj	Numeri i...	Shënimet Për...	Vlera Vendim...
07-170/05-658			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-92 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019), neni 25, paragrafi 5 dhe 6 i Rregullorës Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2026 miraton këtë:

V E N D I M

për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendim të jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme e Komunës, e cila i jepet në shfrytëzim afatshkurt kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, pa procedura të konkurimit.

Neni 2

Me këtë vendim, prona e paluajtshme e cila do të jepet në shfrytëzim është parcela kadastrale me Nr.P-70101025-01457-0, pjesën prej 9m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 24633m², në vendin e quajtur "Ademava Livada", shfrytëzimi aktual i parcelës rrugë e pakategorizuar, e cila evidentohet në emër të p.sh. "Rrugët", në zonën kadastrale në Kabash.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitisë, e cekur në nenin 2 të vendimit është dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, e cila është kërkuar nga KEDS në Viti.

Neni 4

Afati kohor për dhënie në shfrytëzim për trafot elektrike, të cilat shtrihen në parcelat kadastrale të cekura në nenin 2 të këtij vendimi janë (15) pesmbëdhjet vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në rastet specifike.

Neni 5

Prona e paluajtshme e cekur në nenin 2 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim me kompenzim.

Neni 6

Mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes Kryetarit të Komunës së Vitisë dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

Neni 7

Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në neni 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastral të Komunës.

Neni 8

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Vitisë.

Neni 9

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- Skica grafike,
- Kopja e planit, dhe
- Çertifikata e pronës.

Neni 10

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorive kompetente;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi





KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Nr. i aktit: 02-035/02-575	
Data: 26-05-2026	
Vendi: Viti	

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-92, për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03 prill 2019) neni 25 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullorës nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës , neni 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi Vetëqeverisje lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, neni 50 paragrafi 1 shkronja l), të Statutit të Komunës së Vitisë me 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 13.06.2026, bënë këtë :

PROPOZIM VENDIM
PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS KOMPANISË
KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A (KEDS) NË
VITI, PËR VENDOSJEN E TRAFOVE ELEKTRIKE

Neni 1.
Me këtë propozim – vendim prona e palujtshme e Komunës jepet në shfrytëzim afatshkurt Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KEDS) në Viti, pa procedura të konkurimit.

2.
Me këtë propozim – vendim , prona e palujtshme e dhënë në shfrytëzim është :
• Parcela kadastrale me Nr. P-70101025-01457-0, pjesën prej 9m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 24633m², në vendin e quajtur "Ademava Livada", shfrytëzimi aktual i parcelës rrugë e pa kategorizime e cila evidentohet në emër të P.Sh. Rrugët, në zonën kadastrale në Kabash.

Neni 3.
Qellimi i dhenies në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë e cekur në nenin 2 të propozimi është dhënia në shfrytëzim pronës komunale, e cila është kërkuar nga KEDS në Viti.

Neni 4.
Afati kohor për dhënjën në shfrytëzim për trafot elektrike të cilat shtrihen në parcelat kadastrale të cekura në nenin 2 të këtij propozim vendimi është (15) pesmbëdhjet vite , duke e ruajtur të drejtën e nderprerjes së kontratës në rastet specifike.

5.
Prona e palujtshme e cekur në nenin 2 të këtij propozim vendimi jepet në shfrytëzim me kompenzim.

6.
Mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme komunale do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes Kryetarit të Komunës së Vitisë dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

Neni 7.
Prona e palujtshme komunale që jepet në shfrytëzim , e përshkruar në neni 2 të këtij propozim vendimi , duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

8.
Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset : Kryetari i Komunës dhe drejtorit kompetente të Komunes se Vitisë.

9.
Pjesë përberse e këtij propozim vendimi janë :

- Skica grafike
- Kopja e planit dhe cartifikata e pronës

Neni 10.
Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životte Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101025-01457-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 356/2026
Data dhe koha e tëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 14.05.2026 - 08:50
Komuna / Opština / Municipality: VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kabash / Kabash / Kabash
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101025-01457-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		24633			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ADENOVA LIVADA	0			

	DEPARTAMENTI I SISTEMIT TE OPERIMIT	Nr.	KEDS-DSO-F-DSP-09
	KËRKESE PËR LEJE PUNE	Faqe	Faqe 2 prej 2
		Versioni	1.0

